



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 1455 Prot.

Tiranë, 11.3. 2020

Lënda: Kërkohet marja e masave të menjëershme për zbatimin e VKM, Urdhërave dhe Udhëzimeve përkatëse, për të parandaluar përhapjen e COVID-19

Drejtar: Fakultetit \_\_\_\_\_

Institutit \_\_\_\_\_

Filialit të UT, Sarandë

Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare

Administratorit të UT

Drejtorisë \_\_\_\_\_

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 10 mars 2020 “Për caktimin e datave 10 deri 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”; të Udhëzimit 132 datë 08.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”; të Telegramit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. 1952 prot. datë 10.03.2020 “Për zbatimin e masave për moslejimin e grumbullimeve masive në ambjente të hapura dhe të mbyllura”; në Masat e reja, të publikuar në datën 10 mars 2020 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të parandaluar përhapjen e COVID-19, kërkoi nga të gjitha autoritetet drejtuese të çdo njësie kryesore apo çdo njësie tjetër në Universitetin e Tiranës, **marrjen e masave të menjëershme për zbatimin e të gjitha akteve sa më sipër.**

**Sekretaritë mësimore të çdo fakulteti / filiali të mbyllen, duke pezulluar të gjitha shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë deri në datën 3 prill 2020.**

Autoriteti drejtues i çdo njësie, sipas rastit, nëse e gjykon se është i nevojshëm kryerja e një shërbimi, dhe nevojitet kontakti i drejtëpërdrejtë me publikun, t'i kërkojë administratorit të njësisë kryesore dhe Administratorit të UT, të pajisë personelin me mjete mbrojtëse me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre.



---

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Në çdo njësi kryesore dhe në Rektoratin e UT, do të pezullohet ofrimi i shërbimit për konfirmimin e dokumentacionit shkollor, deri në datën 3 prill 2020.

Në lidhje me sa më sipër, të shpallen njoftimi në ambientin e njësisë si dhe në faqen zyrtare të saj.

Gjithashtu, të merren të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen dhe ruajtjen e higjenës dhe pastërtisë në të gjitha ambientet, duke kërkuar nga strukturat përkatëse të bëhet herë pas here edhe dizifikimi i tyre me solucionet dhe mjetet e duhura.

Edhe një hërë, në cilësinë e titullarit të institucionit, kërkoj me shumë forcë respektimin e të gjitha urdhërave, udhëzimeve dhe këshillave të specialistëve të fushave përkatëse sepse lidhet direkt me shëndetin e të gjithë personelit të Universitetit të Tiranës, familjeve të tyre, por edhe me të gjithë komunitetin dhe shoqërinë tonë, për të përballuar me sa më pak pasoja këtë situatë aspak normale dhe tepër të vështirë, me të cilën po përballet vendi ynë.

Nga ana tjetër, shpreh gadishmérinë time për të përballuar të gjithë bashkë, çdo rast apo situatë që mund të keni.

Duke ju urur të gjithëve Shëndet, uroj dhe shpresoj shumë që kjo situatë të kalojë sa më shpejt, që t'i kthehem jetës dhe punës normale në institucion.

